



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 10.1.2025

Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 9, të Vendimit nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, si dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 1 (një) pozicion i lirë Inspektor në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Financës, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6496>

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 1 (një) pozicion i lirë Inspektor në Sektorin e Identifikimit të Mashtrimit dhe Parregullsisve, në Drejtorinë e Parandalimit të Mashtrimit, Parregullsisve dhe Riskut, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6497>

- Për lëvizje paralele dhe ngritjen në detyrë 1 (një) pozicion i lirë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - Klasa e pagës II-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6498>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil, apo kandidatë për pranim në shërbimin civil të aplikojnë për pozicionet vakante të shpallura. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL